

Pyetje dhe përgjigje në gjuhën shqipe

1. Sa zanore ka gjuha shqipe dhe cilat janë ato?

Shqipja jonë ka shtatë zanore. Ato janë: a, e, ë, i, o, u, y.

2. Cilët emra bëjnë pjesë në lakimin e dytë ?

Në lakimin e dytë bëjnë pjesë emrat e gjinisë mashkullore të cilët në rasën emërore të trajtës së shquar të numrit njëjës marrin mbaresën **U. Shembuj: mik-miku, ujk-ujku, peshk-peshku etj.**

3. Sa bashkëtingëllore dyshe ka alfabeti ynë dhe cilat janë ato?

Alfabeti ynë ka 9 bashkëtingëllore dyshe. Ato janë: dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh.

4. Cilin alfabet përdorë gjuha shqipe?

Shqipja jonë përdorë alfabetin latin.

5. Sa shkronja ka alfabeti ynë?

Alfabeti ynë ka 36 shkronja.

6. Cilët janë përemrat vetor?

**Përemrat vetor janë:
për njëjës: unë, ti, ai /ajo
për shumës: ne, ju, ata /ato**

7. Numëro pjesët e ndryshueshme të ligjëratës?

Pjesë të ndryshueshme të ligjëratës janë: emri, mbiemri, përemri, folja dhe numërori.

8. Cilat janë llojet e fjalive sipas kuptimit të tyre shprehës?

Sipas kuptimit shprehës fjalitë janë; dëftore, dëshirore, urdhërore, lidhore, habitore dhe pyetëse.

9. Sa dialekte ka gjuha jonë dhe cilat janë ato?

Gjuha jonë ka dy dialekte: dialektin gegë e toskë.

10. Cilët janë përemrat pyetës?

Përemrat pyetës janë: kush, cili, ç, çfarë.

11. Në cilat kohë janë fjalitë e mëposhtme?

Po bie shumë shi.
Ka rënë shumë borë.
Do të çelin shumë lule.

Fjalìa
Po bie shumë shi- është në kohën e tashme.
fjalìa
Ka rënë shumë borë –në kohën e shkuar.
fjalìa
Do të çelin shumë lule – është në kohën e ardhme.

12. Në tekstin e mëposhtëm dalloni mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm:

”...Po përnjëherësh hapet dera dhe hyn brenda një luftëtar i hijshëm, fisnik dhe madhështor, hundëshkabë, sypëtrit, me mjekër të gjatë e të dredhur, i veshur me çelik, i armatosur gjer në dhëmb...”

Fan Noli

Mbiemra të nyjshëm janë: i hijshëm, të gjatë, të dredhur, i veshur, i armatosur.

Mbiemra të panyjshëm janë: fisnik, madhështor, hundëshkabë, sypëtrit.

13. Kryeni zgjedhimin e foljes **dashuroj** në kohën tashme të mënyrës dëftore në diatezën veprorë.

Unë dashuroj	Ne dashurojmë
Ti dashuron	Ju dashuroni
Ai/ajo dashuron	Ata/ato dashurojnë

14. Formoni disa fjalë tjera nga tema e fjalës **Fjalë**?



Shembull: Fjalor, fjalëkryq, fjali, fjalëmbël, fjalim, fjalosje,etj.

15. Cilat janë shenjat e pikësimit?

Shenjat e pikësimit janë: pika (.), presja(,), pikëpyetje(?), pikëçuditja(!), tri pikat(...), pikëpresja(;), dy pikat (:), thonjëzat(“ ”) dhe viza lidhëse(-).

16. Cilat janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës?

Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës janë: ndajfolja, parafjala, lidhëza, pasthirrma dhe pjesëza.

17. Cilat janë tri degët e mëdha të gramatikës?

Tri degët e mëdha të gramatikës janë: morfologjia, sintaksa dhe fonetika.

18. Cilat janë mbaresat shquese për emrat e gjinisë mashkullore?

Mbaresat shquese për emrat e gjinisë mashkullore janë I dhe U.

19. Cilat kategori gramatikore ka emri?

Emri ka këto kategori gramatikore: rasën, numrin, trajtën dhe gjininë.

20. Gjej emra abstraktë në katrorin e mëposhtëm? Nënvizoi!

Dashuri, zemër,
plagë, liri, fletore,
veturë, urrejtje,
Suedi, gjuetar,
gëzim, top,
hidhërim, dorë ...

Emra abstraktë janë: dashuri, liri, urrejtje,
gëzim, hidhërim.

21. Gjeni antonimin e fjalëve :

natë -	larg -
mirë -	i gjatë -
dimër -	i egër -

Antonime janë fjalët që kanë kuptim të kundërt njëra me tjetrën si p.sh.

natë - ditë	larg - afër
mirë - keq	i gjatë - i shkurtër
dimër - verë	i egër - i butë

22. Në cilin vit u bë unifikimi (standardizimi) i gjuhës letrare shqipe dhe ku?

Unifikimi (standardizimi) i gjuhës shqipe është bërë në vitin 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe që u mbajt në Tiranë.

23. Sa rasa ka emri në gjuhën shqipe dhe cilat janë ato?

Emri në gjuhën tonë ka pesë rasa. Ato janë: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore

24. Rrokje quhet pjesa e ndarë e fjalës që shqiptohet me një nxjerrje të frymës. Gjeni tri fjalë sipas dëshirës dhe ndani në rrokje. Kush përcakton numrin e rrokjeve në një fjalë?

Është numri i zanorëve që përcakton numrin e rrokjeve në një fjalë.

Shembull:

veturë (ve - tu - rë), fletore (fle -to -re), hëna (hë-na) etj .

25. Lakojeni emrin **Ujk** në trajtën e shquar (bestämt form) të numrit njëjës.

ujku
i, e ujkut
ujkut
ujkun
prej ujkut

26. Në cilat raste duhet shkruar me shkronjë të madhe?

Me shkronjë të madhe shkruajmë në fillim të fjalisë, pas pikës dhe kur shkruajmë emra të përveçëm.

27. Kur flasim për alfabetin, na bie të dëgjojmë fjalët: *tingull* dhe *shkronjë*. Po, cili është dallimi i vërtetë në mes tingullit dhe shkronjës?

**Dallimi qëndron këtu:
tingulli dëgjohet kurse shkronja shkruhet.**

28. Ku dallon alfabeti ynë nga alfabeti suedez?

Alfabeti ynë ka 36 shkronja kurse alfabeti suedez ka 29. Alfabeti ynë ka edhe nëntë germa dyshe, pra germa që kanë nga dy shkronja në përbërjen e tyre.

29. Si quhet gjuhëtari i madh shqiptar që shkroi veprën “Studime gjuhësore” në nëntë vëllime?



Eqrem Çabej

Veprën ”Studime gjuhësore” në nëntë vëllime e shkroi Eqrem Çabej.
Çabej u lind në Gjirokastrë në vitin 1908. Ishte një nga gjuhëtarët më të shquar shqiptarë. Studioi gjuhësi në Austri dhe Itali. Ka studiuar Mesharin e Buzukut, fonetikën historike të shqipes dhe ka bërë shumë studime etimologjike në fushë të shqipes. Vdiq më 13 gusht 1980 në Romë.

30. Në gjuhën shqipe folja ka gjashtë mënyra. Cilat janë ato?

**Mënyrat e foljeve në gjuhën shqipe janë:
mënyra dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore**

31. Cilat janë tri kohët themelore të foljeve?

**Tri kohët themelore të foljeve janë:
e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja.**

32. Shkruani me germa këta numëror: 7, 10, 20, 31.

Numërorët e lartshënuar shkruhen kështu me germa:
(7) shtatë, (10) dhjetë, (20) njëzet, (31) tridhjetë e një.

33. Si e formojnë trajtën e shumësit këta emra mashkullor:

njëjës

shumës

një mik
një breg
një dash
një plak
një mësues
një nxënës

shumë.....
shumë.....
shumë.....
shumë.....
shumë.....
shumë.....

Këta emra mashkullor shumësin e tyre e bëjnë kështu:


shumë miq
shumë brigje
shumë desh
shumë pleq
shumë mësues
shumë nxënës

34. Çka janë në morfologji fjalët e shkruara me të kuqe në fjalinë?

Iliri shkruan **shpejt**, **bukur** dhe **saktë**.

Fjalët e shkruara me të kuqe në këtë fjali janë ndajfolje mënyre.

35. Gjeni disa fjalë tjera sinonime te emrit *Nënë!*



Sinonime janë fjalët që shkruhen ndryshe por që kanë kuptim të njëjtë.
Shembull: mami, loke, ëmë, nënëloke, nënoke.

36. Si quhen suedisht këto kategori gramatikore:

ordklasser:

emri

mbiemri

numërori

parafjala

.....
.....
.....
.....

emri quhet **substantiv**
mbiemri quhet **adjektiv**
numërori quhet **räkneord**
parafjala quhet **preposition**

37. Çka janë në gramatikë këto fjalë?

me, ne, nga, afër,
përmbi, nëpër,
ballë për ballë,
sipas, për etj.

Këto fjalë në gramatikë quhen **parafjalë**. Parafjalët janë fjalë të pandryshueshme që qëndrojnë përpara emrave, përemrave, numërorëve dhe ndajfoljeve.

38. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe fjalët e shkruara me ngjyrë të kuqe tregoni se çfarë janë në gramatikë?

Edhe natyra, edhe qielli, edhe pemët tregonin se po largohej dimri.

Fjalët e shkruara me të kuqe janë **lidhëza**. Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme që shërbejnë për të lidhur fjalë, grupe fjalësh ose fjali midis tyre.

39. Fjalët si këto: faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjesi, tungjatjeta, udha e mbarë, tung etj. në gramatikë janë?

Këto fjalë quhen **pasthirrma**. Pasthirrmat janë tinguj ose fjalë të pandryshueshme që shërbejnë për të treguar ndjenjat e folësit.

40. Kur përdorim fjalët jo, nuk, s', mos, jo që jo, as që etj. atëherë kemi përdorur?

Atëherë kemi përdorë **pjesëzat mohuese**. Pjesëzat janë fjalë që plotësojnë kuptimin e një fjalie. Mund të jenë dëftuese, mohuese, përcaktuese, pohuese etj.

41. Shkruani sipas rendit alfabetik emrat e mëposhtëm:

Shkodër, Prizren, Prishtinë, Suedi, Durrës, Austri, Elbasan, Shkup, Australi, Korçë.

Australi, Austri, Durrës, Elbasan, Korçë, Prishtinë, Prizren, Suedi, Shkodër, Shkup.

42. Fjalët: tepsi, pazar, bahçe, oxhak, jastëk, ilaq kanë origjinë të huaj. Cila është origjina e tyre ?

- A angleze
- B suedeze
- C turke

Këto jalë vijnë nga turqishtja. Alternativa C është e saktë.

43. Krahasoni këta mbiemra:

shkalla pohore	krahasore	sipërore
i mirë
interesant
i ëmbël

Krahasimi i këtyre mbiemrave në shqipen tonë bëhet kështu:

<i>Shkalla pohore</i>	<i>krahasore</i>	<i>sipërore</i>
i mirë	më i mirë	shumë më i mirë
interesant	më interesant	shumë më interesant
i ëmbël	më i ëmbël	shumë më i ëmbël

44. Nxirr nga katrori emrat e përveçëm dhe shkruaj ashtu siç duhet?

djalë, tirana, vajzë, prishtina, genci, albana, lule, ängelholm, dardhë, londra , libër, peja, skënderbeu, gustav vasa, tulipan, zog	Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe si p.sh: Tirana, Prishtina, Genci, Albana, Ängelholmi, Londra, Peja, Skënderbeu, Gustav Vasa.
--	--	---

45. Cilën mbaresë shquese marrin emrat e gjinisë femërore?

Emrat e gjinisë femërore marrin mbaresën – a p.sh. Dritë- Drita ose –ja për emrat e përgjithshëm të gjinisë femërore si p.sh: lule- lulja.

46. Cilat janë mënyrat e pashtjelluara të foljeve?

Mënyrat e pashtjelluara të foljeve janë: pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja.

47. Fjalët: **muaj, lexues, fyell, diell** kanë nga dy zanore të shkruara njëra pas tjetrës në përbërjen e tyre. Si quhen këto grupe zanoresh: -ua, -ue, -ye. -ie ?

Këto grupe zanoresh quhen diftongje.

48. Ç`kuptim tjetër sinonimik kanë foljet?

- | | | |
|---------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| <u>filloj</u> | <u>dyshoj</u> | <u>flas</u> |
| <input type="checkbox"/> nis | <input type="checkbox"/> siguroj | <input type="checkbox"/> mendoj |
| <input type="checkbox"/> mbaroj | <input type="checkbox"/> druhem | <input type="checkbox"/> shpresoj |
| <input type="checkbox"/> kryej | <input type="checkbox"/> pajtoj | <input type="checkbox"/> bisedoj |

Kuptimi tjetër sinonimik i foljes filloj është **nis**,
i foljes dyshoj është **druhem**
dhe i foljes flas është **bisedoj**.

49. Prej emrave të shkruar më poshtë krijo folje?

Udhëtim

Këngë

Vizatim

Emrat e dhënë i bëjmë folje në këtë mënyrë:

Udhëtim – udhëtoj

Këngë – këndoj

Vizatim – vizatoj

50. Si quhet ky tip i foljeve në gjuhën shqipe?

ka-m	pat-a	pas-ur
bie	ra-shë	rë-në
ha	hëngr-a	ngrë-në
jap	dha-shë	dhë-në
shoh	pa-shë	pa-rë

Ky grup foljesh përbënë tipin e **foljeve të parregullta**.